



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E KULTURËS, ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2023

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar:

E nderuar

Në përgjigje të shkresës Tuaj me lëndë “Kërkesë për informacion”, Ju bëjmë me dije sa më poshtë vijon:

Bashkia Shkodër në zbatim të funksioneve të saj ka prioritet: 1. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve; 2. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve; 3. Organizimin e festave dhe konkurseve për artin dhe kulturën duke krijuar hapësira të reja në rritjen e komunikimeve dhe shkëmbimeve të vlerave artistike, kulturore dhe historike, në bashkëpunim me komunitetin; 4. Promovimin, vitalizimin dhe zhvillimin e artit e kulturës, duke përkrahur çdo iniciativë publike dhe private me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve dhe zbulimin, nxitjen dhe përkrahjen e talenteve të reja.

Bashkia Shkodër në buxhetin vjetor, të cilin e gjeni të publikuar në faqen zyrtare www.bashkiashkoder.gov.al, ka planifikuar fonde dhe projekte të ndryshme në lidhje me artin, kulturën dhe trashëgiminë kulturore.

Kalendari i aktiviteteve çdo fillim viti i dërgohet Agjensisë Kombëtare të Turizmit si dhe këtë vit për herë të parë është pjesë e aplikacionit TEA.

Bashkia Shkodër çdo aktivitet e promovon rregullisht në rrjetet e saj sociale dhe media lokale dhe kombëtare, duke e bërë të aksesueshme për çdo qytetar dhe turist.

Bashkia Shkodër ka të prodhuara dhe shpërndan materiale të ndryshme informuese dhe promocionale për të gjitha atraksionet, shërbimet turistike dhe të trashëgimisë kulturore, të territorit të Bashkisë Shkodër.

Duke Ju uruar punë të mbarë,

KRYETAR
Benet BECI